



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 118 /2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga subjekti politik LVV , me të cilën pretendohet se më datën 29.04.2012 , prej orës 15:15 në shkollën “Tefik Çanga” 2501d/08R vëzhguesi i subjektit politik PDK Fahredin Beqiri ka lëshuar si zile telefoni vazhdimisht me një fjalim të Hashim Thaçit, brenda në klasë, pas kësaj sipas pretenduesit të ankesës vëzhguesi i subjektit tonë LVV Besart Abazi, ka tentuar të shkruajë këtë parregullsi në Librin e Votimit, Ankesave por nuk është lejuar nga komisioneri, kryesuesi Adrian Hyseni i subjektit politik (AKR), duke i thënë se , “ky libër është vetëm për mua”. Në këtë ankesë është bashkangjitur dëshmia në formë të deklaratës në të cilën vëzhguesi i subjektit politik LVV Besart Abazi me numër personal 1174143222 ka deklaruar se vëzhguesi i subjektit politik PDK Fahredin Beqiri, në thirrjet e telefonit të tij e ka pas ringtoni me fjalimin e Hashim Thaçit. Siç thuhet në deklaratë nga parashtruesi i ankesës ky veprim është përsëritur disa herë dhe për këto vëzhguesi në fjalë ka vendosur të raportojë dhe këtë e ka bërë me Deklaratë që është nënshkruar më datë 30.04.2012.

Sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore 11/2009 neni 6 par 1, a) b) dhe Rregullës Zgjedhore 13/2009 neni 7 par 1 dhe neni 7 par 1 c) f) dhe siç thekson ankuesi se nga kryesuesi Adrian Hyseni është bërë shkelje nga Kodi Penal i Kosovës, neni 1 dhe 2 dhe Rregulloren Zgjedhore 13/2009 nenet 4.1 dhe 4.2.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Ankuesi në ankesë pretendon se vëzhguesi i subjektit politik PDK, Fahredin Beqiri në shkollën fillore “Tefik Çanga” se ka lëshuar zile telefoni me fjalimin e Hashim Thaqit, dhe se kjo vërejtje nuk ju është lejuar vëzhguesit të subjektit politik LVV, të shënojë në Librin e Votimit, nga kryesuesi Adrian Hyseni i subjektit politik AKR. PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë për faktin se në ankesë nuk janë dhënë prova dhe dëshmi të mjaftueshme të cilat eventualisht do ti argumentonin pretendimet e tilla ankimore, andaj duke marr parasysh këtë e në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

A nr. 118 /2012 më datën 03.05.2012.

